



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

VENDIM

Nr 1, Datë dt. 1/2018

Për

Miratimin e “Projektit të zëvendësimit të portës së shkarkimit fundor të digës së Murdharit”.

Në zbatim të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, si dhe nenit 27 të “Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave” të miratuar me VKM nr. 147, datë 18.03.2004, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), në mbledhjen e tij të datës 30.01.2018, mori në shqyrtim materialin e arrdhur nga shoqëria “Hydroenergy” shpk “Projektin e zëvendësimit të portës së shkarkimit fundor të digës së Murdharit.

Pas prezatimit të projektit u prezantua mendimi i Këshillit Teknik për projektin e paraqitur, Këshilli Teknik i KKDM shprehet dakort me projektin e paraqitur si dhe sugjeron që në të ardhmen simbas rezultateve që do të arrihen të shikohen dhe mundësitë e vëndosjes së një porte të dytë (një në punë dhe një shërbimi), si dhe mundësinë e ndërtimit të pritave malore për mbajtjen e materialit të ngurtë.

KKDM mbas diskutimeve të anëtarëve:

VENDOSI

Të miratoj projektin e paraqitur për “Zëvendësimin e portës së shkarkimit fundor të digës së Murdharit”.

Me respekt,

Inxh.Maksim Muçi

K R Y E T A R